

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2009

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2009, konstaton se:

- Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e nenit 164 të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.4.2006.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:

- Plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor, duke u fokusuar në plotësimin e legjislacionit sekondar në fushën e konkurrencës, në përputhshmëri me aktet legislative të Bashkimit Europian;

- Rritjes së komunikimit me tregjet, konsumatorët dhe publikun në tërësi, duke synuar mbrojtjen e interesave të palëve;

- Vendosjes dhe thellimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në tërheqjen e politikave më të mira apo ofrimin e asistencës teknike të nevojshme.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2010 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Rritjen dhe konsolidimin e pozicionit të Autoritetit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve;

- Nxitjen e konkurrencës së lirë dhe mbrojtjen e konsumatorëve, nëpërmjet ndërmarrjes së hetimit në tregun e tranzitimit dhe interkoneksionit në komunikimet elektronike, importit dhe të shitjes me shumicë të karburanteve, importin e grurit, miellit dhe prodhimit të bukës, tregun e bonove të thesarit, tregun e sigurimit të detyrueshëm TPL etj.;

- Plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor të institucionit, në përputhje me praktikën e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian;

- Përfundimin e hetimeve të nisura, si dhe zgjerimin e thellimit të hetimeve në tregje, për të eliminuar deformimet e konkurrencës dhe për të mbrojtur konsumatorët;

- Rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve në tregjet ku shfaqen shenjat e kufizimit të konkurrencës, nëpërmjet përsosjes së teknikave investigative;

- Rritjen e profesionalizmit dhe përafrimin me standardet e autoriteteve homologe, në mënyrë që të forcohet pavarësia e institucionit;

- Rritjen e advokacisë së konkurrencës, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional;

- Rritjen e kulturës për ligjin dhe politikën kombëtare të konkurrencës, duke promovuar partnerhipin dhe bashkëpunimin, kryesisht me komunitetin e biznesit;

- Ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm dhe publikut për rëndësinë e konkurrencës dhe rolin e Autoritetit në ruajtjen e saj, si dhe bashkëpunimin me ta në këtë proces.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Në dhënien dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për monitorimin e tregut dhe hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën në treg;

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

20 maj 2010